



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KAMËZ  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 178 prot.

Kamëz, më 18.12 2020

V E N D I M

Nr. 152 Datë 18.12 2020

P Ë R

**Dhënien e dëmshpërblimit financiar me vlerë prej 83,818,921 (tetëdhjetë e tre million e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e një) lekë (Pa TVSH) për familjet e dëmtuara nga tërmeti i datës 21 Shtator 2019 në territorin e Bashkisë Kamëz.**

**Këshilli Bashkiak Kamëz** i mbledhur sot më 18.12.2020 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19, pasi mori në shqyrtim **Projekt-Vendimin Nr.133 Datë 02.12.2020**, në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligji, Nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile, dhe VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" **Këshilli Bashkiak Kamëz:**

V E N D O S I :

1. Dhënien e dëmshpërblimit financiar me vlerë prej 83,818,921 (tetëdhjetë e tre million e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e një) lekë (Pa TVSH) për familjet e dëmtuara nga tërmeti i datës 21 Shtator 2019 në territorin e Bashkisë Kamëz sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Shuma prej 83,818,921 (tetëdhjetë e tre million e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet e një) lekë (Pa TVSH) do të dërgohet për financim pranë Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në pamundësi financiare nga buxheti i Bashkisë Kamëz.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R E

MIRJETA PRENGA

